



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME  
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.  
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV  
NJËSIA PROKURIMIT**



Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbime Rrjeti Data 2026” për nevojat e shoqërisë  
“Illyrian Guard Sh.a”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
98390000-3- Shërbime të tjera**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 27,387,360** *(Njëzetë e shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë)* **Lekë pa TVSH dhe 288,075.73,** *(Dyqind e tetëdhjetë e tete mijë e shtatëdhjetë e pese presje shtatëdhjetë e tre)* **euro pa TVSH**

**\*Shënim :** Vlerat në lekë janë konvertuar në monedhen euro me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë më datë 10.06.2026 me kurs kembimi 95.07 (Nëntëdhjetë e pese presje zero shtate) leke/Eur.

Sigurimi i ofertës 2%: **547,747.2** *(Pesëqind e dyzetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzetë e shtatë pikë dy)* **Lekë pa TVSH dhe 5,761,51** *(Pese mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nje presje pesëdhjetë e nje)* Euro e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” ShA.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në mbështetje të neneve 76 dhe 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenit 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

#### **b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM Nr 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:** Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), nga data e zhvillimit të tenderit të jetë sa vlera e përllogaritur e marrëveshjes kuadër. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare

konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jete jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të fondit limit. sipas parashikimeve të pikes 2 b) të Nenit 43 të VKM-se.

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare 2023, 2024 dhe 2025, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në Nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku citohet: 1. “Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Për efekte fiskale, të dhënat e dokumenteve të mesipërme quhen të pranuar, kur miratohen nga administrata tatimore ose kur kalojnë dy muaj pas dorezimit të tyre zyrtar dhe administrata tatimore nuk pergjigjet zyrtarisht“, është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij. Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të

*pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë shlyer detyrimet financiare të taksave vendore të parashikuara nga Njësia/të e Pushtetit Vendor për vitin 2025 dhe këstet e maturuara për vitin 2026, referuar Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, në të cilën/at janë regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshillave Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 dhe këstet e maturuara për vitin 2026 sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi. Dokumentet provuese, vërtetimet e kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Në ligjin Nr.9920, date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

### **2.3. Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku citohet: *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, ngadata e shpalljes së njoftimit të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

**2.3.2** Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij te paktën 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të diplomuar në fushën e Telekomunikacionit, Elektronikë, Informatike, Teknologji Informatiori).

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emer, mbiemër) / profilin e punonjësve (fushën e programit të përfunduar) nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit,

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues original ose kopje e noterizuar:

- Diplomat Universitare në programet e studimit në fushën e Telekomunikacionit, Elektronikë, Informatike, Teknologji Informatiori.
- Duhet te figurojne ne Listepagesat e kompanise E-Sig per te paktën 3 (tre) muajt e fundit.

**Argumentimi:** Kërkesa për kualifikimin e nevojshëm profesional është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga çdo operator ekonomik që ka në objektin e veprimtarisë së tij ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe internetit.

Ky shërbim është i një rëndësie të veçantë për shoqërinë “Illyrian Guard” sh.a., duke pasur parasysh se interneti përbën infrastrukturën bazë të komunikimit ndërmjet administratës qendrore, sallave operative dhe zyrave në qarqe. Për këtë arsye është kërkuar një shërbim i vazhdueshëm dhe cilësor 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Operatori ekonomik është i detyruar të sigurojë monitorimin, mirëmbajtjen dhe suportin teknik të nevojshëm për funksionimin e pandërprerë të rrjetit, ndaj vlerësohet i domosdoshëm disponimi i jo më pak se 3 punonjësve

të kualifikuar, duke marrë në konsideratë edhe shtrirjen gjeografike të strukturave të shoqërisë.

Ky kriter mbështetet në pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**2.3.3.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë specialiste të certifikuar si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) Specialist të certifikuar PMP për menaxhimin e projekteve / Ekuivalent.
- b) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) Specialist të certifikuar CCNA , Associate Routing and Sëiching / Ekuivalent.
- c) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 Specialist të certifikuar për Sigurinë Kibernetike /ose ekuivalent.
- d) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) Specialist për sigurine e rrjetit/ose ekuivalent.
- e) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) Specialist të certifikuar SCTE (min certifikim në nivel teknik) ose ekuivalente.

**Shenim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikim.**

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje certifikimet e punonjesve dhe listepagesat perkatese E-Sig.*

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emer, mbiemër) / profilin e punonjësve (tipin e certifikatave përkatëse) nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

- Certifikatat përkatëse sipas kërkesës së Autoritetit.
- Duhet te figurojne ne Listepagesat e kompanise E-Sig per te pakten 3 (tre) muajt e fundit.

**Argumentimi:** Kërkesa për kualifikimin e nevojshëm profesional është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga çdo OE, i cili ka në objektin e veprimtarisë së tij këtë natyrë shërbimi.

Duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë të ndërtimit, administrimit dhe operimit të një infrastrukture të avancuar Intranet “Rrjeti Data”, i cili të garantojë komunikim të sigurt, të

qëndrueshëm dhe të centralizuar ndërmjet të gjitha pikave operative dhe nyjeve të rrjetit të Autoritetit Kontraktues në rang kombëtar, si dhe nevojën për garantimin e funksionimit të pandërprerë, të sigurt dhe cilësor të këtij rrjeti 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë, disponimi i specialistëve të mësipërm vlerësohet i domosdoshëm për të siguruar administrimin, monitorimin, mirëmbajtjen dhe ndërhyrjen e menjëhershme në rast të problematikave teknike, duke garantuar sigurinë, stabilitetin dhe vazhdimësinë e shërbimit.

- a) Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 2 (dy) Specialist të certifikuar PMP për menaxhimin e projekteve / Ekuivalent.

Certifikimi PMP ose ekuivalent vërteton se personi zotëron njohuri profesionale mbi:

- Hartimin dhe ndjekjen e planit të zbatimit të projektit;
- Koordinimin e ekipeve teknike të angazhuara në realizimin e kontratës;
- Menaxhimin e afateve, burimeve dhe aktiviteteve të projektit;
- Identifikimin dhe administrimin e risqeve që mund të ndikojnë në realizimin e kontratës;
- Monitorimin e performancës dhe raportimin periodik të progresit;
- Garantimin e cilësisë së deliverables dhe përmbushjen e objektivave të kontratës;
- Sigurimin e vazhdimësisë së menaxhimit të projektit gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Prania për dy specialistë garanton disponueshmërinë e kapaciteteve menaxhuese gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, si dhe mundëson mbulimin e njëkohshëm të proceseve të planifikimit, koordinimit dhe monitorimit të aktiviteteve teknike.

- b) Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 2 (dy) Specialist të certifikuar CCNA, Associate Routing and Switching / Ekuivalent.

Certifikimi CCNA ose ekuivalent vërteton se personi zotëron njohuri profesionale mbi:

- konfigurimin dhe administrimin e rrjeteve IP;
- menaxhimin e pajisjeve aktive të rrjetit (router/sëitch);
- implementimin e protokolleve të komunikimit;
- diagnostikimin dhe zgjidhjen e problematikave të rrjetit;
- garantimin e sigurisë dhe performancës së infrastrukturës së komunikimit elektronik.

Prania për dy specialistë është thelbësore për të garantuar ekspertizën e nevojshme teknike për menaxhimin e infrastrukturës së rrjetit të kërkuar në këtë projekt. Certifikimet CCNA dhe ekuivalentët e tyre vërtetojnë aftësinë për diagnostikimin e problemeve të rrjetit, menaxhimin e trafikut, konfigurimin e pajisjeve enterprise dhe zbatimin e arkitekturave të sigurta teknike, që janë thelbësore për një shërbim me kërkesa të rrepta SLA.

- c) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 Specialiste të certifikuar për Sigurinë Kibernetike /ose ekuivalent.

Certifikimi në siguri kibernetike ose ekuivalent vërteton se specialisti zotëron njohuri dhe aftësi profesionale për:

- monitorimin dhe menaxhimin e incidenteve të sigurisë dhe analizave të vulnerabiliteteve;
- analizimin, identifikimin dhe parandalimin e kërcënimeve kibernetike;
- monitorimin e sigurisë dhe vlerësimin e riskut;
- analizimin dhe reagimin në kohë ndaj problematikave që cenojnë disponueshmërinë dhe integritetin e sistemit.

Duke qene se ne kete procedure kerkohet mbrojtje nga sulmet DDOS eshte e domosdoshme qe OE te disponoje minimalisht nje person pergjegjes per sigurine kibernetike duke pasur parasysh edhe rëndësinë e vecantë që ka përdorimi i intranetit si infrastrukturë komunikimi ndërmjet entiteve qëndrore me ato lokale të IG sh.a. por edhe lidhjet me jashtë IG sh.a.

- d) Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 2 (dy) Specialist per sigurine e rrjetit/ose ekuivalent.

Punonjesi i certifikuar per sigurine e rrjetit siguron mbrojtjen e infrastruktures dhe te dhenave te organizates qe kalojne permes rrjetit per te shmangur dhe parandaluar sulmet. Fokusi qëndron tek mbrojtja e infrastrukturës së rrjetit, kontrolli i aksesit, monitorimi i trafikut, konfigurimi i mekanizmave të sigurisë së rrjetit dhe mbrojtja ndaj sulmeve DDoS.

- e) Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 2 (dy) Specialist të certifikuar SCTE (min certifikim në nivel teknik) ose ekuivalente.

Prania e specialistëve të certifikuar garanton dispononim të personelit me aftësitë e nevojshme për të siguruar implementimin dhe funksionimin e qëndrueshëm të infrastrukturës së rrjetit. Në rast se certifikimi nuk është i lëshuar nga SCTE, pranohen certifikime ekuivalente nga organizata të tjera ndërkombëtare, për aq kohë sa ato mbulojnë të njëjtat aspekte teknike dhe praktike në fushën e rrjeteve dhe telekomunikacionit.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme te ISO-ve, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuar) te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:

- a) **ISO 9001:2015 ose ekuivalent** certifikatën e menaxhimit të cilësisë së shërbimit ose ekuivalent , që kanë lidhje me objektin e kontratës;
- b) **ISO 27001:2022 ose ekuivalent** për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit ose ekuivalente në lidhje me objektin e kontratës,
- c) **ISO 20000-1:2018 ose ekuivalent** për sistemin e menaxhimit shërbimit te teknologjise dhe informacionit ose ekuivalente në lidhje me objektin e kontrates.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e Nenit 36 dhe Nenit 77, pikes 1 te nenit 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet:

*“1.Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*

Si dhe Nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet: 1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për te kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.*

a)Standarti i cilesise **ISO 9001:2015 ose ekuivalent**:-eshte sot referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave.Standardi ISO 9001 siguron që operatori punon me procedura të strukturuar dhe të audituara, duke garantuar stabilitet dhe performancë gjatë gjithë ciklit të kontratës.Gjithashtu, në këtë shërbim kërkohen SLA strikte, eliminim i doëntime gjatë implementimit, raportime mujore, regjistra të testimeve, procedura të verifikimit dhe trajectory të qarta për menaxhimin e defekteve. ISO 9001 siguron që operatori ka mekanizma të brendshëm për monitorim të cilësisë, për trajtim të shpejtë të problemeve dhe për përdorimin e metodologjisë CAPA për korrigjime dhe masa parandaluese. Pa këtë standard, autoriteti kontraktor nuk do të kishte garanci se operatori mund të përmbushë kërkesat e rrepta dhe cilësinë e nevojshme për një infrastrukturë kritike në nivel kombëtar Certifikata e menaxhimit të sigurisë së informacionit **ISO 27001:2022 ose ekuivalent** -është standardi ndërkombëtar më i njohur për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS). Ky standard percakton kërkesat për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e risqeve që lidhen me sigurinë

e informacionit, duke siguruar mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave.

**b)Kërkesa për posedimin e certifikatës ISO 27001:2022 ose ekuivalent është e nevojshme për të garantuar se operatori ekonomik:**

- Zbaton politika dhe procedura të dokumentuara për menaxhimin e sigurisë së informacionit;
- Disponon mekanizma për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve të sigurisë;
- Siguron mbrojtjen e të dhënave dhe sistemeve nga akseset e paautorizuara, humbja apo komprometimi i informacionit;
- Zbaton masa organizative dhe teknike për parandalimin dhe menaxhimin e incidenteve të sigurisë;
- Operon sipas standardeve të njohura ndërkombëtare në fushën e sigurisë së informacionit;
- Garanton përmirësim të vazhdueshëm të proceseve që lidhen me mbrojtjen e informacionit dhe sigurinë e rrjetit.

Duke qenë se objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me infrastrukturën e komunikimeve dhe rrjetit të të dhënave, ku siguria e informacionit është element kritik për funksionimin normal të sistemeve, kërkesa për certifikimin ISO 27001:2022 ose ekuivalent është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon procese të standardizuara dhe të certifikuara për menaxhimin e sigurisë së informacionit.

Për rrjedhojë, ky kriter konsiderohet i nevojshëm, proporcional dhe në përputhje me kërkesat teknike të kontratës, duke garantuar mbrojtjen e informacionit dhe besueshmërinë e shërbimeve që do të ofrohen gjatë zbatimit të saj. Në mungesë të këtij standardi, nuk do të ishte e mundur të garantohej siguria institucionale dhe ligjore që kërkon ky lloj shërbimi.

**c)Përmbushja e standartit *ISO 20000-1:2018 ose ekuivalent* - është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e shërbimeve që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të shërbimeve dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të shërbimit. Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të IT konfirmon angazhimin e operatorit ekonomik për të ofruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve.**

Ofrimi i shërbimit, i përket fushës së teknologjisë së informacionit dhe është e nevojshme pajisja me këtë ISO nga kompania ofertuese për realizimin në mënyrë efektive dhe në përputhje me kërkesat e “Illyrian Guard” ShA. ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës ,i cili përcakton kërkesat për planifikimin, ofrimin, monitorimin, kontrollin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve IT. Standardi përshkruan një seri procesesh menaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre), cila jep metodologjinë dhe

kornizën për të ndihmuar kompanitë të menaxhojnë ITSM. Me kërkesat e standardit kompanitë aplikojnë praktikat më të mira, duke ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve IT.

**2.3.5** Operatori Ekonomik /Ofruesi i shërbimit duhet të paraqese vërtetim nga AKEP për të vërtetuar prezencën e rrjetit tokesor të OE në të gjitha të gjitha pikat në qytetet në të cilat kërkohej shërbimi. Ky rrjet duhet të jetë i publikuar pranë Regjistratit Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS).

Për këtë duhet të paraqitet Autorizimi i vlefshëm nga AKEP ose një kontratë qeraje/marveshje bashkëpunimi në ato pika të cilat operatori ekonomik ofertues nuk mund t'i mbulojë me rrjet.

**Argumentim:** Për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, Operatori Ekonomik duhet ta vërtetojë duke dorëzuar Autorizimin e Përgjithshëm nga AKEP që përbën kuadrin ligjor, të përcaktuar nga Ligji nr. 9918 dhe rregullat e nxjerra nga AKEP-i, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrime specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një propozim teknik të shoqëruar me skemat e rrjetit të ofertuesit, për zgjidhjen teknike për ofrimin e shërbimit si dhe planin e back-up për ofrimin e shërbimit, duke përfshirë edhe mbrojtjen nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet për linjën e internetit në site primar nëpërmjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatik të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu; mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastrukturës BGP (Border Gateway Protocol), mbrojtje në bazë volumetrike, rrugëzim (routing) të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qëndërzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Monitorim 24 orë /7 ditë dhe suport nga specialistë me eksperiencë në këtë shërbim. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mbrojtjen DDoS në disa perimetra sigurie (multi layer DDoS protection në të gjithë perimetrat e sigurisë, lokale, kombetare dhe nderkombetare). Gjithashtu për platformen e përdorur për ofrimin e shërbimit DDoS, operatori ekonomik duhet ta provojë duke paraqitur kontratën e blerjes/suportit të platformes respektive ose kur operatori ekonomik është vetë prodhues i platformës .

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e propozimit Teknik dhe kontratës së blerjes/suportit të platformes respektive për mbrojtjen DDoS ose kur operatori ekonomik është vetë prodhues i platformës .

**Argumentimi :** Ky kriter mbeshtetet ne pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe i shërben AK qe te kete besueshmërinë qe OE ofertues ka kapacitetet e nevojshme per realizimin e kontratës objekt prokurimi, sipas përcaktimeve te bëra ne Termat e Referenes.

Mbrojtja kundër sulmeve DDoS (Distributed Denial of Service) është thelbësore për të siguruar që rrjeti të mbetet funksional dhe të mos ndikohet nga sulmet që synojnë të mbingarkojnë infrastrukturën e tij. Kjo siguron një nivel të lartë të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimit, duke mbrojtur interesat e institucionit dhe të dhënat e tij sensitive.

Mbrojtja ndaj sulmeve DDoS (Distributed Denial of Service) është një komponent thelbësor për garantimin e **disponueshmërisë, reziliencës dhe sigurisë së vazhdueshme** të sistemit. Kjo kërkesë siguron transparencë teknike, qartësi në mënyrën e implementimit, si dhe mundëson verifikimin paraprak të konstruksionit të rrjetit, konfigurimeve, pajisjeve dhe metodologjisë që operatori do të përdorë. Skemat e rrjetit ndihmojnë autoritetin kontraktor të kuptojë qartë topologjinë e propozuar, rrjedhën e trafikut, pikat e ndërlikohjes, segmentimin e rrjetit dhe arkitekturën e sigurisë, duke garantuar që propozimi përputhet plotësisht me kërkesat teknike dhe standardet e sigurisë të parashikuara.

Po ashtu, kërkesa për një plan të detajuar të back-up-it siguron që operatori ekonomik ka parashikuar mënyra alternative për ofrimin e shërbimeve në çdo pikë, edhe në rast të dështimit të linjës primare. Plani i back-up tregon nëse operatori ka zgjidhje të besueshme, redundancë të mjaftueshme, teknologji rezervë dhe strategji për rikuperim të menjëhershëm pa ndërprerje të funksionalitetit, duke garantuar përputhshmëri me kërkesat për SLA, disponibilitet dhe integritet të të dhënave. Kjo ndihmon autoritetin kontraktor të minimizojë riskun operativ dhe të sigurohet se operatori zotëron kapacitetet e nevojshme teknike dhe infrastrukurore për të përballuar çdo skenar emergjent ose situatë të papritur.

#### **2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Zgjidhjen e detajuar teknike sipas indikatorit të cilësisë të përshkruar në specifikimet teknike bashkëlidhur.
- Bllok-skemën totale të sistemit për zgjidhjen e ofruar dhe teknologjinë që ai përdor.
- Zgjidhjen e detajuar me skemë logjike dhe kontraten përkatëse për ofrimin e shërbimit të mbrojtjes DDOS duke treguar qartësisht edhe scrubing center ku operatori do të drejtojë trafikun në rast sulmesh.

**Argumentimi :** Ky kriter mbeshtetet ne pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe i shërben AK qe te kete besueshmërinë qe OE ofertues ka kapacitetet e nevojshme per realizimin e kontratës objekt prokurimi, sipas përcaktimeve te bëra ne Termat e Referenes. Kërkesa për **zgjidhje të detajuar teknike sipas indikatorëve të cilësisë** është një element kyç për të garantuar që zgjidhja e ofruar është e **përshtatshme, funksionale, e qëndrueshme dhe e**

**verifikueshme**, si dhe për të lehtësuar fazat e zbatimit dhe auditimit teknik pas kontraktimit. Paraqitja e **bllok-skemës së plotë dhe përshkrimit të teknologjisë** është një komponent thelbësor për vlerësimin teknik të ofertës dhe për garantimin që zgjidhja e ofruar është funksionale, e zbatueshme dhe në përputhje me kërkesat specifike të projektit. Përfshirja e një zgjidhjeje të mbrojtjes ndaj DDoS me **skemë logjike dhe scrubbing center të dokumentuar**, jo vetëm që siguron sigurinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve, por është gjithashtu një kërkesë minimale për përputhshmëri me standardet moderne të sigurisë së rrjetit dhe infrastrukturës digjitale.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër të gjitha Kërkesat Funksionale dhe Specifikimet Teknike të kërkuara nga AK.

**Argumentim:** Ky kriter është jo diskriminues është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, do t'i përgjigjet kërkesave të AK në rast instalimi dhe riparimi defektsh me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.3.9** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër realizimin e kontratës sipas afateve dhe kritereve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikime teknike.

**Argumentim:** Ky kriter është jo diskriminues është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të përmbush detyrimin kontraktual ndaj AK, do t'i përgjigjet kërkesave të AK në rast instalimi dhe riparimi defektsh me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike, në mbështetje të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për shërbimin rrjeti data për shoqërinë “Illyrian Guard” sh.a.

Nëpërmjet këtij shërbimi synohet të arrihet ndërtimi, administrimi dhe operimi i një infrastrukture të avancuar Intranet “Rrjeti Data”, i cili të garantojë komunikim të sigurt, të

qëndrueshëm dhe të centralizuar ndërmjet të gjitha pikave operative dhe nyjeve të rrjetit të Autoritetit Kontraktues në rang kombëtar.

## **NJESIA E PROKURIMIT**